



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 64, datë 04.03.2021

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER” SH.P.K., PËR TRANSFERIM TË
ASETEVE (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK”
SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “a”, nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pikat 1.3, dhe 1.6, të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 7 dhe nenit 11, pika 1, të Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.07.2016 si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të asetëve në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të asetëve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
- Në vijim të depozitimit për trajtimin në bord të relacionit përfundimtar nr. 33/2 prot., datë 01.03.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.a., për transferim të asetëve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a”, në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., nr. 127/2 prot., i ERE-s, datë 02.03.2021, “Plotësim dokumentacioni”, në lidhje me kërkesën e sipërcituar.

Ajo që konstatohet paraprakisht është se shoqëria ka depozituar Kontratë Hipotekimi dhe listë asetesh, por duke qene se ky dokumentacion është depozituar në prag të përfundimit të afatit të vendimmarrjes së ERE-s, është e nevojshme shtyrja e vendimmarrjes finale për këtë praktikë në mënyre që të vijohet me njohjen dhe analizimin e sa përcjellë nga shoqëria në plotësim të aplikimit të saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të asetëve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI